

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji i përbërë; nga gjyqtarët: Gani Avdiu Kryesues, Mediha Jusufi e Ramë Hyseni, - anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditësve, S.I. nga fsh. ... dhe F.M. nga fsh. ... Komuna e Podujevës, të përfaqësuar nga Z.I. av. në Prishtinë, kundër të paditurave: Kompania e Sigurimeve “INSIG” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga B.D. dhe KS “Croatia Sigurimi” e përfaqësuar nga B.S., për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurave, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, C.nr.619/2013 të dt.30.12.2014, pas mbajtjes të seancës së kolegjit, me datë 07.09.2017, jep:

## **A K T G J Y K I M**

**Refuzohen** si të pathemeltë ankesat e të paditurave KS “INSIG” dhe KS “Croatia Sigurimi”, dhe **Vërtetohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë C.nr.619/2013 të dt. 30.12.2014, me përjashtim të vendimit për kamatëvonesën i cili **Ndryshohet** dhe gjykohet si vijon: *Me kamatë vonesë, e cila rrjedh nga dt. 04.03.2010 si ditë e dhënies së aktgjykimit në shkallë të parë e deri në pagesën definitive të borxhit.*

## **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega Podujevë, me aktgjykimin C.nr.619/2013 të dt.30.12.2014, ka vendosur si vijon:

“Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësve S.I. nga fshati ..., Komuna Podujevë, dhe F.M. nga fshati ..., Komuna Podujevë, kundër të paditurave KS “Insig dhe KS “Croatia Sigurimi” me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi jo material dhe material, si e bazuar dhe Detyrohen të paditurat që paditësve, t’iu paguajnë shumat si vijon:

1. Për paditësin S.I., e paditura e parë KS “INSIG” për 70% të përgjegjësisë:

a. Për dëmin jo material:

-në emër të dhembjeve fizike shumën prej 650euro

-në emër të frikës së përjetuar shumës prej 600 euro

b. Për dëmin material:

-për shpenzimet gjatë kohës së shërimit 14 euro,

Përtej shumës së aprovuar shuma tjetër prej 150 euro, refuzohet si e pa bazuar.

2. Për paditësin e dytë F.M., dy të paditurat të paguajnë sipas shkallës së përgjegjësisë dhe atë e paditura e parë KS “Insig” për 70% të përgjegjësisë dhe e paditura e dytë KS “Croatia Sigurimi” për 30% të përgjegjësisë:

a. Për dëmin jo material:

-në emër të dhimbjeve fizike e paditura e parë shumës prej 910 euro, ndërsa e paditura e dytë shumën prej 390 euro

-në emër të frikës së përjetuar e paditura e parë shumën prej 800 euro, ndërsa e paditura e dytë shumës prej 300 euro

-për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 5% e paditura e parë shumën prej 1,400 euro ndërsa e paditura e dytë shumën prej 600 euro

b. Për dëmin material

-për shpenzimet gjatë kohës së shërimit dhe rehabilitimit klimatik e paditura e parë shumën prej 303.8 euro, ndërsa e paditura e dytë shumën prej 130.2 euro.

Përtej shumës së aprovuar shuma tjetër prej 1,600 euro, refuzohet si e pa bazuar.

Gjithsejtë shuma e aprovuar për kompensim material dhe jo material është 6,098 euro dhe këtë shumë obligohen të paditurat t’ia paguajnë paditëseve me kamatë siç e paguajnë Bankat Komerciale të Kosovës për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e nxjerrjes së ekspertizës mjekësore 15.09.2009, e deri në pagesën përfundimtare.

II. Obligohen të paditurat ti paguajnë shpenzimet procedurale në shumës prej 1.750, ndërsa KS “Croatia Sigurimi” shumën prej 525 euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë”.

Kundër këtij aktgjykimi të paditurat, përmes përfaqësuesve të tyre brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë, për të gjitha shkaqet e parapara me nenin 181 të LPK. Ankesat e paraqitura janë të lejueshme dhe të plota pra i përmbushin kërkesat ligjore për procedim lidhur me themelësinë e tyre.

*Përfaqësuesit i të paditurave në ankesë kanë kërkuar që të aktgjykimi ankimor të ndryshohet në favor të pretendimeve ankimore ose i njëjti të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim.*

*Kolegji, gjen se ankesat janë të pathemelta.*

Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore, të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2 nën par. b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, në procedurë sipas ankesës kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera procedurale që do të ishin me ndikim në vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në këtë çështje kontestimore.

***Nga shkresat në lëndë rezulton se*** Gjykata e shkallës së parë për vërtetimin gjendjes faktike kishte marrë provat e specifikuar në arsyetimin e aktgjykimit ankimor dhe ka konstatuar se: në mes palëve procedurale nuk janë kontestuese faktet se më dt.03.07.2009, në rrugën magjistrale Podujevë – Prishtinë, në fshatin Gllamnik, janë aksidentuar veturat “Daimler Benz” me targa ...-KS-..., dhe vetura “Golf 19E” me targa ..-KS-7..., si pasojë e këtij aksidenti lëndim trupore kishin pësuar S.I. (lëndime të lehta trupore) dhe pasagjeri i tij F.M. (lëndime të rënda trupore). Automjetet e aksidentuar ishin të siguruara te të paditurat. Kompanitë e sigurimeve, KS “INSIG” dhe KS.“Croatia Sigurimi”.

Aksidenti ishte shkaktuar nga lëshimet primare të të siguarit të paditurës KS.“INSIG”, drejtuesit të veturës “Daimler Benz” me targa ...-KS-..., si dhe nga lëshimet sekondare të drejtuesit të veturës “Golf 19E”, me targa ...-KS-...2 të siguarit të paditurës KS.“Croatia Sigurimi”.

Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi S.I. kishte pësuar lëndime të lehta trupore, ndrydhje të kokës, ndrydhje të trupit, si pasojë e të cilave kishte përjetuar dhembje fizike dhe frikë të intensitetit dhe kohëzgjatjes së cekur në arsyetimin e aktgjykimit ankimor, ndërsa paditësi F.M. kishte pësuar lëndime të rënda trupore, si pasojë e të cilave gjithashtu kishte përjetuar dhembje fizike, frikë dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor shkallën prej 5%.

Lëndimet e paditësve si dhe dëmi jo material që ata kishin përjetuar si pasojë e lëndimeve trupore, ishin përcaktuar nga mjeket kompetent i caktuar me vendim të gjykatës dhe atë: Dr.A.T. – Ortoped, Dr.N.M. – Psikiatër dhe Dr.F.Q. – Neurokirurg.

Fakt kontestues në mes të ndërgjygjësve ishte se kush kishte kontribut më të madh në shkaktim e ngjarjes aksidentale si dhe në shkaktimin e dëmit ndaj paditësve.

Për konstatimin e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë kishte marr provën mendimin e ekspertit të komunikacionit, Mr.sc.Y.K. i cili kishte vlerësuar se shkaktar i aksidentit është ngasësi i veturës me targa ..-KS-..., i siguruari i të paditurës KS “INSIG”, ashtu që me veprimin e tij kyçje e pasigurt nga parkingu në rrugën magjistrale, deri sa në atë rrugë në një afërsi ishte duke lëvizur vetura “Golf 19E” të cilën e drejtonte i siguruari i të paditurës KS.“Croatia Sigurimi”. Këtij aksidenti i kishte kontribuar edhe drejtuesi i veturës “Golf 19E”, në rritjen e vëllimit të dëmit dhe pasojave të këtij aksidentit, për shkak të shpejtësisë lëvizëse prej 83 Km/h.

I siguruari i të paditurës KS.“INSIG” drejtuesi i veturës “Daimler Benz”, ishte shpallur fajtor me aktgjykim penal të Gjykatës Komunale në Podujeve P.nr.141/2010 të datës 12.12.2012, dhe ishte gjykuar me gjobë.

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, kishte vlerësuar se aksidenti është shkaktuar me fajin e drejtuesve të automjeteve përkatëse dhe atë me kontributin prej 70% të siguruarit të paditurës KS.“INSIG” dhe 30% të siguruarit të paditurës KS.“Croatia Sigurimi” tani paditësit S.I..

Gjykata e shkallës së parë kishte gjykuar shumat për kompensimin e dëmit jo pasuror si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, duke vlerësuar se ato janë në përputhje me dispozitat ligjore të neneve 154,155,178,185 dhe 200 të LMD, dhe përfaqësojnë satisfaksion adekuat për paditësit, duke e zbritur kontributin e paditësit S.I. në shkaktimin e dëmit, e sipas bazë ligjore të nenit 178 të LMD.

Ndërsa sa i përket gjykimit në emër të kompensimit të demit pasuror, të cilin janë detyruar të paditurat t’ia paguajnë paditësve, është i bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë dhe plotësisht, dhe duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 193 par.2 të LMD.

*Pretendimet ankimore:* E paditura Kompania e Sigurimeve “Croatia Sigurimi”, në ankesën e parashtruar ka pohuar se në shkaktimin e aksidentit ka kontribuar 10% - 20% e jo në lartësinë prej 30%. Në mbështetje të këtij pretendimi ankimor nuk ka paraqitur fakte as prova të reja.

E paditura kompania e sigurime “INSIG” në ankese ka theksuar se kontributi i saj në shkaktimin e demit është 60%, ndërsa kontributi i të paditurës së dytë është 40%. Në mbështetje të këtij pretendimi ankimor *nuk ka paraqitur fakte e as nuk ka propozuar prova të reja.*

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike në të cilën drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Nuk është i vetëmjaftueshëm vetëm pretendimi i të paditurave në këtë rast së ngjarja aksidentale ditën kritike është shkaktuar sipas kontributit të pretenduar të pjesëmarrësve në aksident, por pretendimet duhet të provohen me fakte dhe prova relevante, të mjaftueshme dhe të besueshme.

Më nenin 919 të LMD-së, së vjetër të viti 1978 i cili në këtë rast përfaqësonte ligj të zbatueshëm në kohën e shkaktimit të dëmit, është përcaktuar: ***”Kur të këtë ndodh rasti i siguruar, siguruesi ka për detyrë të paguaj shpërblimin ose shumën e caktuar...”***

Kolegji, e vlerëson të ligjshëm dhe të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të shprehur në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, sepse me nenin 200 të LMD, është përcaktuar:

*“Për dhembje të pësuar fizike, për dhembjet e pësuar për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor si dhe për frikën, gjykata, po të konstatoj se rrethanat e rastit, sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla... gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkëlqes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim... të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.”*

Pra, në rastin konkret të paditurat nuk provuan së shumtë e gjykuara në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, nuk janë në harmoni me qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, përkatësisht se ato nuk janë në përputhje me kriteret si dhe me praktiken gjyqësore të krijuar gjatë zbatimit të së drejtës materiale për gjykimin e kësaj forme të kompensimit të dëmit, si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 178 lidhur me nenin 192 të LMD, për përgjegjësinë e pjesëtuar sipas shkallës së fajësisë përkatësisht kontributit të pjesëmarrësve në aksident, në shkaktimin e dëmit.

Sa i përket ndryshimit të aktgjykimit ankimor në pjesën që ka të bëjë me kamatëvonesën, ai bazohet në nenin 277 të LMD së vitit 1978 si dhe në praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, për këtë çështje në procedurë sipas revizionit.

**Sipas qëndrimit të Gjykatës Supreme, kamatëvonesa rrjedhë nga dita e dhënies së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.** Pra në këtë rast kamatëvonesa është caktuar nga dita e dhënies së aktgjykimit C.nr.388/2009, të dhënë për herë të parë në gjykatën e shkallës së parë me datën 04.03.2010, e jo nga data e marrjes së mendimit të ekspertit, siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë, në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Kolegji, vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë i dhënë në aktgjykimin ankimor, sa i përket shpenzimeve procedurale, ishte i bazuar në ligj sepse ai ishte marrë në bazë të suksesit të ndërgjyqësve në këtë kontest, dhe si i tillë bazohej në dispozitat ligjore të neneve 452.2.5 lidhur me nenin 453.1 të LPK.

Sa i përket vendimit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë për pjesën refuzuese të kërkesëpadisë duke u bazuar në nenin 194 të LPK, ai nuk është ekzaminuar nga kolegji, sepse nuk ishte i goditur fare me ankesë si mjet i rregullt juridik.

Më sa u tha më lartë kolegji, vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga nenet 200 e 201 të LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË**  
**CA.nr.1215/2015 dt.07.09.2017**

**Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari**  
**Gani Avdiu,**